



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 27/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Ferit Osmani dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Organizatës Demokratia në Veprim dhe subjekteve politike Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat me, Anr. 27/2011 dhe Anr.31/2011 të datës 09.01.2011 të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV)

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar dy ankesa më datë 09.01.2011, nga subjekti politik LVV, me të cilat pretendohet se:

Ankesa Anr. 27/2011. Në këtë ankesë theksohet se më datë 09.01.2011 rreth orës 12:48 në qendrën e votimit 2123b në Izbicë komuna Skenderaj udhëheqësi i vëzhguesve të LVV, Naim Bunjaku e ka vërejtur anëtarin e Demokracisë në Veprim, Nysret Xhemajli duke shpërndarë fletushka të kandidatëve të PDK-së. Vëzhguesi LVV ia ka tërhequr vërejtjen pas kësaj ka marr kërcënime si prej Nysret Xhemajlit e poashtu edhe prej anëtarëve tjerë të PDK-së. Më këtë rast parashtresuesi i ankesës konsideron se është bërë shkelje e nenit 34.1 të LZP-së dhe neni 36 par.1 pika (a) të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike.

Ankesa Anr. 31/2011. Në këtë ankesë theksohet se në fshatin Izbicë komuna e Skenderajt rreth orës 16:00, është kërcënuar udhëheqësi i vëzhguesve të LVV Naim Bunjaku për faktin se ka dashtë vërejtjet të shënoj në librin e votimit për atë që ka vërejtur të njëjtit duke votuar disa herë. Koordinatorin e PDK-së pranë kësaj qendre të votimit Nysret Xhemajli bashkë me koordinatoren e subjektit politik AKR kanë uzurpuar Librin e Votimit dhe nuk e lejonin të njëjtin që të shkruaj vërejtjet. Sipas parashtresuesit të ankesës Naim Bunjaku ka qenë seriozisht i kërcënuar për këtë e kanë lajmëruar edhe policinë e Kosovës në ora 16:43. Më këtë rast parashtresuesi i ankesës konsideron se është bërë shkelje e nenit 34.1 dhe 34.2 të LZP-së.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) dhe neni 6.3 parashohin:

3.6.c hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

6.3 Me qellim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, kryesuesi i panelit mund të vendose ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vetë çështje të ngjashme, paneli vendimmarrës i trajton ato si kur të ishin një ankesë”.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesat janë të pabazuara.

Nga shkresat e lendes, dhe atë gjatë shqyrtimit të ankesave të lartcekura gjeti se në të dy ankesat bëhet fjalë për personin e njëjtë Nysret Xhemajli, për të cilin në njëërën ankesë thuhet se është anëtarë i Demokracisë në Veprim e në ankesën tjetër thuhet se është koordinator i PDK-së, ndërsa të dy ankesat janë për të njëjtën Qendër të Votimit në fshatin Izbicë komuna Skenderaj. Nga pretendimet e parashtruesit të ankesave, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesa janë të pabazuara nga shkak se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se kanë ndodhur shkeljet e tilla. Këtë e bënë edhe më të besueshëm raporti i Policisë i datës 09.01.2011 për ditën e rivotimit të datës 09.01.2011 në fshatin Izbicë komuna e Skenderajt, në të cilin theksohet se: Vëzhguesi i LVV Naim Bunjaku ka kërkuar që të marrë librin e ankesave për të shkruar disa pakënaqësi për rrjedhën e votimit ndaj personit Nysret Xhemajli, për këtë në raport potencohet se fillimisht nuk është lejuar ndërsa më vonë është lejuar dhe ai i ka shpreh ato pakënaqësi në librin e ankesave dhe ka vazhduar procesin e votimit normalisht. Andaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 27/2011 më datën 13.01.2011

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

